



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

L ë n d a: Mbledhja e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave

KKN

Minutat e takimit

Datë 27.12.2023

Më datë 27 dhjetor u zhvillua online mbledhja e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturat (KKN). Axhenda e takimit ishte:

1. Plani i aktiviteteve për 2024;
2. Informim mbi rishikimin e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev2.1;
3. Informim mbi aktivitetin e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023;
4. Çështje të tjera

Kryetarja e KKN, Znj. Elsa Dhuli bëri prezantimin e rendit të ditës e cila u miratua pa ndryshime. Takimi vijoi sipas axhendës.

Plani i aktiviteteve për vitin 2024

Znj. Dhuli, prezantoi draft planin e aktiviteteve të KKN-së për vitin 2024 si dhe afatet e përcaktuara për realizimin e tyre. Çështjet në fokus gjatë vitit 2024 janë si më poshtë:

- *Propozimi i listës së nomenklaturave të reja për shqyrtim dhe atyre për rishikim sipas kërkesave të anëtarëve të KKN;*
- *Vlerësimi i nevojave për trajnime në funksion të zbatimit në praktikë të nomenklaturave;*
- *Finalizimi i planit të aktiviteteve për vitin 2024;*
- *Miratimi i raportit mbi ecurinë e zbatimit të nomenklaturave gjatë vitit 2023.* Sekretariati se bashku me përfaqësuesit e INSTAT do të punojnë mbi raportin për veprimtarinë e komisionit gjatë vitit 2023. Në takimin e parë për vitin 2024, ky raport do ju prezantohet anëtareve të komisionit;
- *Miratimi i planit të aktiviteteve të KKN-së për vitin 2024;*
- *Raportimi mbi ecurinë e zbatimit të Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike të revizionuar, NVE Rev2.1 dhe të tjera zhvillime;*
- *Ngritja e grupeve të punës për organizimin e trajnimeve;*
- *Raportim mbi ecurinë e zbatimit të NVE Rev2.1;*
- *Miratimi i NVE Rev2.1;*

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- Përgatitja e raportit vjetor mbi nivelin e zbatimit të nomenklaturave, problemet e ndeshura dhe, sipas rastit, propozimet për zgjidhje të mundshme.

Në kuadër të prezantimit të draft planit të aktiviteteve për vitin 2024, Znj. Dhuli u ndal më gjatë në zhvillimet e fundit të Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike të rishikuar, NVE Rev2.1. Komisioni Evropian, grupi i punës për klasifikimet dhe nomenklaturat pranë EUROSTAT, ka miratuar versionin NVE Rev2.1. Baza ligjore përkatëse që shoqëron nomenklaturën si strukturë dhe notën shpjeguese do të fillojë detyrim zbatimin për vendet e bashkimit evropian në janar të vitit 2025. Duke qenë se është një akt rregullator i bashkimit evropian, përkthimi i nomenklaturës NVE Rev2.1 është planifikuar si akt ligjor i cili do të shoqërohet me një vendim të Këshillit të Ministrave. Në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian, PKIE, ky klasifikim është planifikuar të miratohet gjatë 4-mujorit të parë të vitit 2025. Është kusht i domosdoshëm që në 4-mujorin e parë të vitit 2025 klasifikimi të miratohet me vendim të KM.

INSTAT në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë e cila ka dhe përkthyesit e certifikuar do fillojnë punën për përkthimin e NVE Rev2.1. Më tej klasifikimi do të kalojë për konsultim publik, për diskutime me stafin e ministrive dhe institucioneve që anëtarët e komisionit përfaqësojnë. Raporti i finalizuar do të paraqitet për miratim në KKN.

Gjatë vitit 2024, në një nga takimet, sektori i Regjistrat Statistikor të Ndërmarrjeve do të paraqes një raport mbi ndikimin e ndryshimeve të kodeve të reja në Regjistrat e Biznesit.

INSTAT gjatë vitit 2024 është dhe në vitin e rishikimit të Llogarive Kombëtare. Kjo nomenklaturë nuk ndikon në revizionimin e serive të Llogarive Kombëtare 2024 pasi dhe me rregullore zbatimi i nomenklaturës fillon gjatë vitit 2025. Revizionimi i ardhshëm do të kryhet me nomenklaturën e re NVE Rev2.1.

Përfaqësuesit e DPT, BSH, QKB si dhe AKSHI e kanë të domosdoshme fillimin e trajnimit të punonjësve të tyre me nomenklaturën e re pasi janë institucionet e para që preken nga zbatimi i kësaj nomenklature.

Znj. Dhuli informoi anëtarët gjithashtu mbi zhvillimet më të fundit të Klasifikimit Ndërkombëtar të Krimeve, ICCS. Në drejtim të grupit të punës së ngritur me përfaqësues nga institucione të tjera, ky proces ka përfunduar. Klasifikimi nuk ka ardhur ende për trajtim dhe miratim përfundimtar në komision sepse ky klasifikim lidhet ngushtë me Kodin Penal i cili është në proces rishikimi. Pasi të miratohet do të bëhet një tabelë korrespondence midis kodit penal shqiptar dhe klasifikimit ICCS. Nëse do të kemi zhvillime të reja në lidhje me këtë çështje, anëtarët do të njoftohen gjatë takimit të dytë të komisionit.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Informim mbi rishikimin e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2.1

Znj. Flutura Sala, përgjegjëse pranë sektorit të RSN bëri një prezantim informues mbi NVE Rev2.1, të bazës ligjore si dhe të ndryshimeve të ardhura si pasojë e rishikimit:

- Seksioni G është ri-emërtuar “Tregtia me shumicë dhe Pakicë”;
- Tregti dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave – “ndarja 45” është hequr dhe aktivitetet janë zhvendosur në ndarjen 46 “Tregti me shumicë”, 47 “Tregti me pakicë” dhe 95 “Riparim dhe mirëmbajtje”;
- Tregtia me pakicë: shitjet online dhe ato në dyqane nuk janë të ndara - mjetet e shitjes nuk merren më në konsideratë;
- Një seksion i ri K – 'Telekomunikacioni, programimi kompjuterik, konsultimi, infrastruktura kompjuterike dhe aktivitete të tjera të shërbimit të informacionit', rezulton nga ndarja e seksionit J të vjetër NVE Rev.2 - 'Informacioni dhe komunikacioni' në dy seksione;
- Pas seksionit K, të gjitha seksionet e tjera të NACE Rev.2.1 shkojnë në një shkronjë më tej në rend alfabetik.
- Shërbimet e ndërmjetësimit – janë krijuar grupe (3digit) dhe klasa (4digit) për aktivitetet e shërbimit të ndërmjetësimit në ndarjet ekzistuese të dedikuara;
- Aktivitetet që lidhen me Fintech (Financial Technology) janë integruar në klasat ekzistuese të NVE seksionit L (nuk ka klasa specifike për aktivitetet e fintech);
- Seksioni i vjetër R - "Artet, argëtimi dhe çlodhja" është riemërtuar në S - "Arte, sporte dhe rekreacion".

Ndër të tjera, Znj. Sala shtoi që hartimi i planit të zbatimit të NVE Rev2.1 duhet të mbajë parasysh shtatë elementë kryesorë:

- Zhvillimi i një klasifikimi kombëtar;
- Vlerësimi fillestar i ndikimit të ndryshimit në statistikat zyrtare;
- Trajnimi i stafit të institucioneve që ofrojnë burimet administrative që vendosin dhe përdorin kodin e aktivitetit ekonomik (DPT , QKB etj);
- Rishikimi dhe miratimi i akteve ligjore kombëtare;
- Zbatimi në Sistemin Kombëtar Statistikor;
- Mbajtja e dy kodeve NVE Rev2 dhe NVE Rev2.1 për të siguruar cilësinë dhe zbatimin e plotë të klasifikimit të ri;

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Informim mbi aktivitetin e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023

Znj. Dhuli bëri një prezantim të Censit të Popullsisë dhe Banesave të zhvilluar në territorin e Shqipërisë gjatë periudhës 18 Shtator-31 Tetor. Censi i Popullsisë dhe Banesave ofron të dhëna mbi numrin zyrtar të popullsisë në një vend, në njësinë më të vogël gjeografike, së bashku me informacionin mbi një numër të zgjedhur të karakteristikave demografike, sociale dhe ekonomike të popullsisë. Në mënyrë të ngjashme, Censi i banesave ofron numërimin zyrtar të banesave në vend në njësinë më të vogël gjeografike, së bashku me informacionin mbi një numër të zgjedhur të karakteristikave të banesave. Cens është aktiviteti më madhor statistikor që zhvillon një shtet.

Periudha e terrenit zgjati 6 javë dhe për zona të veçanta kryesisht me ndërtime të reja pas tërmetit, u zgjat afati i mbledhjes së informacionit deri në 15 Nëntor. Menjëherë pas kësaj periudhe u zhvillua anketa pas Cens (PES) e cila mat përqindjen e mbulimit të Cens apo të disa elementëve të cilësisë së këtij procesi. PES u zhvillua në 100 zona të territorit të vendit (të zgjedhura në mënyrë rastësore) dhe përfundoi më datë 22 Dhjetor.

Angazhimi i qytetarëve si dhe i personave të angazhuar në proces (anketues-kontrollor-supervizor-përfaqësues INSTAT) ishte shumë i lartë. Në janar 2024 fillon përpunimi i të dhënave për tu finalizuar më tej me publikimin e rezultateve përfundimtare të Cens në nivel kombëtar (Qershor 2024).

Znj Dhuli shtoi që Cens është aktiviteti më madhor statistikor që një vend zhvillon pasi kryhet një herë në 10 vjet. Mund të themi që aktiviteti u krye me sukses falë dhe mbështetjes së shumë aktorëve që bashkëshoqëruan INSTAT në këtë aktivitet.

Përgatiti:

Sekretariati i KKN
04 Dhjetor 2024

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al